

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kokaina në Portin e Durrësit, gjurmët të çojnë te “Gjenerali” në Belgjikë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391841.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 16:00:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 15:45:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 15:44:00 UTC → 15 shtator 2026, 15:46:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8b23e56331b1a2d614c4a4ace1a54895972b17eca36c52b4266d2fcc51532d1
TEKSTI	78dc52dd73f81450be728452d8778b2a4ad497c8a305f4c010e88305148ade7c
PAMJA	51752a646e7eeaf30de5deea7f00475ed17ca49f73c3d6b53e1e8114d7f982de

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	66c85b9545f0d619b7c0dc50303cd9a5172ef73bff951834168302fd7d7ce37d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/66c85b9545f0d619b7c0dc50303cd9a5172ef73bff951834168302fd7d7ce37d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kokaina në Portin e Durrësit, gjurmët të çojnë te “Gjenerali” në Belgjikë

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 15.09.2026, 17:45

 Share

 Share



41.35 kilogramë kokainë, 37 pako të fshehura në kapakët e jashtëm të një kontejneri frigoriferik me mish pule nga Brazili dhe një hetim ndërkombëtar që duket se nuk ndalet te brigjet e Durrësit. Pas sekuestrimit të rreth 2 milionë eurove drogë në port, gjurmët e hetuesve të çojnë drejt Belgjikës dhe një grupi shqiptar të dyshuar për trafik ndërkombëtar kokaine.

Kontejneri që mbërriti në Durrës kishte nisur udhëtimin nga Brazili dhe kishte kaluar tranzit edhe përmes Greqisë. Por, përpara se mishi i pulës të përfundonte në Shqipëri, duket se kontejneri kishte edhe një “ngarkesë surprizë” që nuk figuroi në dokumente: 37 pako me kokainë, të vendosura në një mënyrë që kërkonte kontrolle të imta për t’u zbuluar.

Pikërisht në të njëjtën ditë kur në Durrës u sekuestrua droga, autoritetet belge goditën një grup shqiptar të dyshuar për trafik ndërkombëtar kokaine. Hetimi, i zhvilluar prej rreth një viti në bashkëpunim me autoritete të disa shteteve dhe Europolin, çoi në arrestimin e tetë personave.


Mes tyre është një shqiptar 48-vjeçar, i cili dyshohet se shërbente si ndërmjetës mes grupeve kriminale në Shqipëri dhe rrjeteve të kokainës në Amerikën Latine. Sipas hetuesve belge, ai siguronte kontakte për importimin e sasive të mëdha të drogës përmes Portit të Antwerp-it, ndërsa lidhjet e tij dyshohet se shtriheshin edhe te grupe të tjera kriminale në Europë dhe deri në Australi.

Dhe këtu hyn në skenë një emër që për autoritetet shqiptare nuk është aspak i panjohur: Gerd Gjinarari, i njohur si “Gjenerali”.

48-vjeçari i arrestuar në Belgjikë dyshohet se kishte kontakte me Gjinararin, i cili ishte shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare për vrasje dhe është dënua me burgim të përjetshëm. Në qershor të këtij viti, “Gjenerali” u arrestua në Belgjikë, ndërsa në kuadër të këtij hetimi ndaj tij dhe personave të tjerë janë vendosur masa.

Pra, kemi një grup shqiptar të goditur në Belgjikë, një ndërmjetës të dyshuar për lidhje me rrjetet e kokainës në Amerikën Latine, kontakte me “Gjeneralin” dhe, në të njëjtën kohë, një ngarkesë me 41.35 kilogramë kokainë që udhëton nga Brazili, kalon përmes porteve të tjera dhe përfundon në Durrës. Rastësi?

Autoritetet belge duket se nuk e kanë parë si një histori të shkëputur. Sipas



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

Prokurorisë së Antwerp-it, një prej rezultateve të netimit ndërkombëtar ishte pikërisht sekuestrimi i 37 paketimeve me kokainë në Shqipëri. Kjo e vendos ngarkesën e Durrësit në të njëjtën hartë hetimore me operacionin belg.

Por, si gjithmonë në këto raste, duhet bërë dallimi mes asaj që dihet dhe asaj që dyshohet. Deri tani nuk ka një konfirmim zyrtar nga autoritetet shqiptare se Gerd Gjinarari ka lidhje me kokainën e kapur në Durrës dhe as se kompania që kishte porositur mishin e pulës kishte dijeni për drogën e fshehur në kontejner.

Por pyetjet tashmë janë aty. Kush e futi kokainën në kontejner? Kush e dinte se ku ndodhej? Kush priste ta merrte në Shqipëri? Dhe mbi të gjitha, a është ngarkesa e Durrësit pjesë e të njëjtit rrjet që po hetohet nga autoritetet belge?

Nga Brazili në Greqi, nga Belgjika në Shqipëri dhe nga një kontejner me mish pulë të 41.35 kilogramë kokainë, rruga e kësaj ngarkese duket se ka shumë më tepër kthesa nga sa do të kishte një transport normal ushqimor.

Tani mbetet të shihet nëse hetimi do të ndjekë edhe këto gjurmë apo në Durrës do të mbetet sërisht vetëm kontejneri dhe "surpriza" që fshihej në kapakët e tij.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt